



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-1890/23
Kaçanik, 31.01.2023

Kuvendi i Komunës Kaçanik në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008) në mbledhjen e vet të mbajtur me 31 janar 2023, pos tjerash e prezantoj,

**Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës nga Inaugurimi i Kuvendit
08 dhjetor 2021-31 dhjetor 2022**

1. Në këtë Informatë është paraqitur, Aktiviteti i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga Inaugurimi i Kuvendit 08 dhjetor 2021-31 dhjetor 2022.
2. Në aktivitetin e Kuvendit të Komunës është pasqyruar në formë të shkurtër funksionimi i Kuvendit të Komunës dhe të trupave punuese të tij, përmbushja e përgjegjësisive të përcaktuara me Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimeve Administrative, Statutit të Komunës, Rregullores për punë të KK, Planit të Punës për vitin 2022, të realizuara në mbledhje të rregullta dhe në aktiviteteve tjera.
3. Aktiviteti i pasqyruar i Kuvendit të Komunës nga pika 1. e kësaj shkrese është i regjistruar me Nr. të protokollit 01Nr. 60/01-1890/23 dhe i njëjti do të jenë transparentë për qytetarët e Komunës së Kaçanikut, OJQ, Grupe të interesit dhe për çdo të interesuar tjetër.

Me këtë shkrese njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursefi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	19.01.2023	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	od 60/01-1890	Shtojcë	-1.



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

INFORMATË

PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
NGA INAUGURIMI I KUVENDIT 08 DHJETOR 2021 -31 DHJETOR 2022

Kaçanik, Janar 2023

PËRMBAJTJA:

HYRJE

QËLLIMI

ORGANET E KOMUNËS

PËRBËRJA E KUVENDIT

INAGUGURIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS

INAUGURIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

ZGJEDHJA E KRYESUESIT TË KUVENDIT

NDRYSHIMET NË KUVENDIN E KOMUNËS

SHEFAT E GRUPEVE PARLAMENTARE

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

KOMITETET E KUVENDIT

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE

AKTIVITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

AKTIVITETE TË TJERA

SHËRBIMI I KUVENDIT

PËRFUNDIM

SHTOJCA:

LISTA E AKTEVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS NË VITIN 2021

I. VENDIMET

LISTA E AKTEVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS NË VITIN 2022

I. RREGULLORET

II. VENDIMET

III. RAPORTIMET E KRYETARIT TË KOMUNËS

Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim, informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe grupeve tjera të interesit, funksionimin e Kuvendit të Komunës të legjislaturës shtatë (7) në aktivitetin një (1) vjeçar, respektivisht periudha nga Inaugurimi i Kuvendit 08 Dhjetor 2021- 31 Dhjetor 2022. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

Organet e Komunës

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, janë :

1. Kuvendi i komunës; dhe
2. Kryetari i komunës.

Kuvendi i Komunës, është organi më i lartë vendimmarrës në komunë, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës, në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale (neni 35.1).

Kryetari i Komunës, zgjidhet në zgjedhjet e drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale (neni 56.1).

Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 17 tetor 2021, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 5 subjekte politike me numër të mandateve: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 12 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 8 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 2 mandate, Nisma për Kosovën (NISMA) me 1 mandat.

Sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite. 37.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar: a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij; b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur; c) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij; d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj; e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye; f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të pa për zgjidhshëm. 37.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lista e 27 anëtarëve të zgjedhur të Legjislaturës së shtatë (7):

1	2	3	4
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
01.	Brahim Imishti	anëtar	PDK
02.	Kemal Murseli	anëtar	PDK
03.	Hamide Luma	anëtar	PDK
04.	Kadri Krivenjeva	anëtar	PDK
05.	Fitore Vishi	anëtar	PDK
06.	Rrustem Zenuni	anëtar	PDK
07.	Edon Baftiu	anëtar	PDK
08.	Selajdin Troni	anëtar	PDK
09.	Fatmir Bunjaku	anëtar	PDK
10.	Bashkim Krasniqi	anëtar	PDK
11.	Florina Lika-Vishi	anëtar	PDK
12.	Lejla Muhaxheri-Çaka	anëtar	PDK
13.	Agim Mani	anëtar	LVV
14.	Kadrije Lika-Troni	anëtar	LVV
15.	Adnan Reka	anëtar	LVV
16.	Naim Beça	anëtar	LVV
17.	Raif Kasa	anëtar	LVV
18.	Ernesta Krasniqi	anëtar	LVV
19.	Bashkim Luma	anëtar	LVV
20.	Arta Avdiu	anëtar	LVV
21.	Ardita Rrahmani	anëtar	LDK
22.	Besnik Salihu	anëtar	LDK
23.	Betim Shala	anëtar	LDK
24.	Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	LDK
25.	Hafize Sallahi	anëtar/ Dorëheqje	AAK
	Rabije Sallahi	anëtar/ Zëvendësuar	AAK
26.	Ekrem Livoreka	anëtar	AAK
27.	Agim Çaka	anëtar	NISMA

Në zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, ka fituar pozitën e anëtarit të Kuvendit të Komunës, Besim Ilazi nga subjekti politik i PDK, mirëpo për shkak të zgjedhjes së tij Kryetar i Komunës Kaçanik, ka ofruar dorëheqje dhe i njëjti është zëvendësuar nga KQZ me kandidatin e radhës nga po i njëjti subjekt politik - PDK, Brahim Imishti.

Inaugurimi i Kuvendit të Komunës

Inaugurimi i Kuvendit është bërë me 08 dhjetor 2021, ku e dhanë betimin 27 anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen inauguroese e ka ftuar Kryetari në detyrë i Komunës,

Besim Ilazi, ndërkaq e ka udhëhequr anëtari me i vjetër i KK, Kadri Krivenjeva deri me zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Përmbajtja e betimit për anëtar të kuvendit

“Unë _____ betohem se do t'i kryej detyrat me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, si dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë”.

Sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite. 37.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar: a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij; b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur; c) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij; d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj; e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye; f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm. 37.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Inaugurimi i Kryetarit të Komunës

Në mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të Komunës të datës 08 dhjetor 2021 e ka dhënë Betimin, Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi – nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës- PDK, cili i ka fituar në zgjedhjet lokale të datës 17 Tetor 2021, respektivisht në Rundin e dytë të votimit të datës 14 Nëntor 2021.

Përmbajtja e betimit për kryetar komune

Unë, _____, “Betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Kaçanikut, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

Sipas nenit 56.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i Komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare. 56.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon; a) kur ta kryejë mandatin e tij; b) nëse vdes; c) nëse jep dorëheqje; d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër; e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye; f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj; g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike; dhe h) në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër. Kompetencat e kryetarit të komunës janë të përcaktuara në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit

Me shumicë votash në mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të Komunës të datës 08 dhjetor 2021 është zgjedhur me votim të fshehur, Kryesuesi i Kuvendit Kemal Murseli nga PDK me 14 votë për ndërkaq kundër kandidati i tij Ekrem Livoreka nga AAK ka marrë 1 votë. Në votim kanë marrë pjesë 23 anëtarë. Vota të vlefshme 15, vota të pavlefshme 08 votë, nuk kanë votuar 4 anëtarët nga LDK.

Sipas dispozitave të nenit 41, Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve. Kryesuesi i kuvendit të komunës zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit. Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë me shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

Ndryshimet në Kuvendin e Komunës

Kuvendi i Komunës në ndërkohë pëson ndryshime, ashtu që Hafize Sallahi – anëtare e KK nga subjektit politik i AAK jep dorëheqje nga pozita e anëtarit të KK, për shkak të emërimit të saj, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, pasi që me një marrëveshje politike, Partia Demokratike e Kosovës - PDK dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK janë në lidhje koalicioni. Zëvendësimi i anëtares së dorëhequr Hafize Sallahi është bërë me 29.12.2021 me anëtares nga po i njëjti subjekt politik- AAK, Rabije Sallahi, për shkak të emërimit të saj për drejtor të drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Shefat e Grupeve Parlamentare:

- 1.Nga PDK, Shef i GP është caktuar, Fitore Vishi, 12 ulëse.
Pas dorëheqjes se Fitore Vishi, është caktuar Shef i GP, Rustem Zenuni
- 2.Nga LVV Shef i GP, është caktuar Agim Mani. 08 ulëse
3. LDK Shef i GP është caktuar, Ardita Rrahmani, 4 ulëse,
4. Në emër të AAK, fjalën e merr, Ekrem Livoreka, 2 ulëse
5. Në emër të NISMA, fjalën e merr Agim Çaka, 1 ulëse.

Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregulloreve të punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja për Punë të Kuvendit të Komunës (kapitulli VII dhe VIII), përcaktojnë rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të

Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca të rregullta në vit respektivisht deri në 12 seanca me pagesë, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit.

Gjatë vitit 2021 Kuvendi i Komunës së Legjislaturës së shtatë(7) ka mbajtur një mbledhje inauguruese dhe 1 mbledhje të rregullt.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2022 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Të gjitha mbledhjet e rregullta janë mbajtur në sallën e kuvendit dhe kanë qenë të hapura për publikun. Gjatë vitit 2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në vitin 2022 ka mbajtur 3 mbledhje solemne: 1. Në nderim të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës 17 shkurtit 2008, 2. Ditës së Çlirimit të Komunës 11 Qershor 1999, 3. Ditës së Dëshmorëve, 10 Gushtit. Mbledhja solemne e 11 Qershorit është mbajtur në vendin e quajtur "Kulla e Hasanit" në f. Bob, ndërkaq 2 mbledhjet tjera solemne janë mbajtur në sallën e KK.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KK në mbledhjet e rregullta ka qenë kryesisht e rregullt, ka pasur ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtari.

Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa; dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Komiteti për Politikë dhe Financa është në përbërje prej 7 anëtarëve:

1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, çështjet financiare dhe çështje të tjera me rëndësi për komunën, siç janë; rregulloret komunale, raporteve financiare. KPF ka pasur kompetencë të bartur për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë të ndërtimore të PK të klasës së 5 dhe 6. Kjo kompetencë iu është marrë nga KK në vitin 2022, me pëlqimin e KPF, për shkak të kërkesave të palëve për ndërrimin e destinimit të sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore të klasës 5 dhe 6. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës.

Komiteti për Komunitete, është në përbërje, 5 anëtarë;

1. Lejla Muhaxheri –Çaka	PDK	anëtar
2. Arta Avdiu	LVV	anëtar
3. Betim Shala	LDK	anëtar
4. Ekrem Livoreka	AAK	anëtar
5. Arben Thaqi	OJQ/ Shoqëria civile	anëtar.

Kryesues i këtij komiteti është zgjedhur Ekrem Livoreka.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje që kanë qenë të parapara me planin e punës të mbahen në këtë vit. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës.

Kuvendi i Komunës nga viti 2019 e ka të formuar një (1) Komitet Konsultativ: Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Ky Komitet aktivitetin e tij e ka filluar nga muaji shtator 2019, ndërkaq gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej 2 mbledhje nga të 6 sa kanë qenë të planifikuara. Në mbledhjet e këtij komiteti janë shqyrtuar çështjet që lidhen kryesisht me nevojat e PAK, duke iu referuar Planit të veprimit për PAK në Kaçanik. Ky komitet ka pasur përbërjen 7 anëtarë kur është formuar, ndërkaq gjatë vitit 2022, dy anëtarë të këtij komiteti, Artan Mezraja- Kryesues i këtij komiteti dhe Arxhenta Axhami kanë dhënë dorëheqje, ndërsa anëtarja Albana Fuga ka ofruar dorëheqje në vitin 2021. Pas dorëheqjes së kryesuesit të këtij komiteti, këtë komitet e ka udhëhequr zëvendës kryesuesja Mirlinda Axhami-Hysa. Aktiviteti i komiteteve të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në formë me të gjerë do të raportohet me Raport të veçantë të punës të secilit komitet.

Ekzekutivi i Komunës

Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, në mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës. 28.01.2022, ka prezantuar në Kuvendin e Komunës emërimet në Ekzekutiv, si vijon:

Sabedin Vishi, Nënkryetar i Komunës

Drejtorët e drejtorive komunale:

1. Dardana Tafili- Dauti- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme;
2. Sali Malsiu- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale
3. Zahir Doda- Drejtorja e Arsimit;
4. Bahri Selimi- Drejtorja e Buxhetit dhe Financave;
5. Qamil Stagova- Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
6. Ramadush Osmani- Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
7. Suhad Dullovi- Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
8. Hafize Sallahi- Drejtorja e Kulturës , Rinisë dhe Sportit;
9. Pranvera Loku-Zharku- Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili këshill ka raportua sipas Udhëzimit Administrativ që rregullon formimin, detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli. Kryesues i KKSB është Besim Ilazi, sipas detyrës zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës ka formuar komisione me mandat të caktuar dhe komisione ad hoc, si: Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM “Pastërtia” SH.A. –Njësia Kaçanik, Komisionit Komunal të Aksionarëve N.P.K. “Stacioni i Autobusëve” SH.A. -Njësia Kaçanik, Komisioni përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore (ad hoc). Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale. Ky komision për aktivitetin e tij ka raportuar 1 herë në KK. Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2023(ad hoc), Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës (ad hoc). Ky komision ka

rekomanduar KK me i dhënë në shfrytëzim 2 prona komunale 3 ofertuesve të përzgjedhur, mirëpo të njëjtat i janë kthyer në rishqyrtim komisionit, për me caktuar afatin kohor të dhënies në shfrytëzim. Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, është i formuar për mandat 2 vjeçar, ashtu siç e përcakton ligji. Ky komision ka shqyrtuar ankesat që i ka pasur në dispozicion, ndërkaq me kërkesën e KK për shkak të balancimi gjinor dhe nevojës me u ndryshuar, është ndryshuar dhe plotësuar në mbledhjen e fundit të KK. Kur jemi të komisionet e kuvendit, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

Njoftimet për mbledhje

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike, pasi anëtarët e KK janë të pajisur me laptop.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e komunës dhe në facebookun zyrtar të komunës. Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale, Zyrës së Informimit dhe Zyrës së IT dhe OSBE.

Aktiviteti i Kuvendit të Komunës

Në periudhën Janar – Dhjetor 2022, Kuvendi i Komunës ka pasur në rend pune 115 pika, ndërkaq nga inaugurimi 08 dhjetor 2021- 31 dhjetor 2022 ka pasur 16 pikë, gjithsej 131 pikë. Në kuadër të rregullat-ivës normative, KK ka aprovuar: Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës, Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr.346-18740/2013 të datës 29.07.2013 për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve, Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive në Komunën e Kaçanikut, Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale. Nga aktet tjera, KK ka aprovuar janë: Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025, Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025.

Kuvendi i Komunës ka debatuar Raportet periodike buxhetore, Planin vjetor të Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023, Planin vjetor të Kuvendit për vitin 2023, Raporti i Kryetarit për aktivitetin e përgjithshëm të Komunës për vitin 2021, Raportin e menaxhimit të burimeve njerëzore për vitin 2021, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK, Raporte dhe Plani i KKS, Raporte që lidhen me aktivitetin e shkollave për fillimin apo përfundimin e vitit shkollor, Raport të punës së Shtabit komunal për parandalimin e Pandemisë Covid-19, Raportin për ecurinë e zgjedhjeve të këshillave lokale.

Gjatë vitit 2022 Kuvendi i Komunës ka miratuar 74 Vendime, ndërkaq në vitin 2021 pas konstituimit 8 vendime. Aktet e miratuara ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të

qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë vendime për këmbimin e pronave, ndërrimin e destinimit të pronave bujqësore, vendim që drutë e konfiskuara t'ua ndajë shkollave të komunës. KK ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, harmonizim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas propozim vendimeve të Kryetarit të Komunës, për një shpenzim më të mirë buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor. Gjatë vitit 2022 Kuvendi i Komunës ka diskutuar Plani e punës së ekzekutivit për vitin 2022, ndërkaq ka aprovuar plane për periudha kohore: 3, 4 apo 5vjeçare, si: Plani për integritet, Planin e reagimit emergjent, Strategjia për komunikim dhe informim, Planin e veprimit për transparencë, Planin e menaxhimit të mbeturinave. Në vitin 2022 janë bërë ndryshime në Komitetin për Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, pasi që kanë ofruar dorëheqje 2 anëtarë të këtij komiteti. Gjatë periudhës raportuese vlen të përmenden miratimi i Vendimit për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçaniku dhe vendimi për miratimin e simbolit përkujtimor "Lulëkuqja me katër petale" të gjenocidit në Kosovë. Në vitin 2022 është diskutuar për aktivitete kundër dhunës në baza gjinore. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatoj Kuvendi i Komunës në seancën e vet, paraprakisht Komiteti për Politikë dhe Financa i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq pjesa dërmuese e çështjeve kanë pasur për bazë Propozim Vendimet, Propozim Rregulloret, Draft Planet, të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorive Komunale.

Aktiviteti i Kuvendit të Komunës Kaçanik mund të vlerësohet së ka qenë shumë i mirë, nuk ka pasur lëshim apo bojkotim të asnjë mbledhje, çështjet kryesisht janë aprovuar me shumicë votash, disa nga çështjet janë miratuar njëzëri, është përdorur vota e dyfishtë "Për" e kryesuesit të KK për 1 vendim, ndërkaq nuk e ka marrë miratimin një vendim për shfuqizim për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, sipas kërkesës së ministrisë. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur konflikt të interesit të anëtarëve të KK, ndërkaq Kryetari i Komunës në një mbledhje e ka deklaruar me gojë konfliktin e interesit në dy pikë. Sfidë në zhvillimin e aktiviteteve të KK, mbeten kushtet e punës për mbledhje të KK, për shkak të sallës jo të përshtatshme dhe mungesa e foltores.

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës në vitin 2022, ku forma e raportimit financiar ka qenë me shkrim katër (4), ndërkaq një (1) herë në vitin 2021 pas konstituimit të KK, dhe në formë verbale çdo herë kur është kërkuar. Një (1) herë është raportuar për aktivitetin e përgjithshëm të komunës, një (1) herë për menaxhimin e burimeve njerëzore. Kryetari ka raportuar përmes shërbimeve përkatëse profesionale, 1 herë për çështjen e auditimit të brendshëm, dy (2) herë për zbatimin e rekomandimeve, tre (3) herë është raportuar për çështjen e arsimit, një (1) herë për parandalimin e Pandemisë Covid-19. Gjithashtu ekzekutivi i komunës i është përgjigjur në formë të shkruar disa Kërkesave dhe Pyetje të anëtarëve të KK, ndërkaq KK ka kërkuar të merr përgjigje me shkrim për çdo pyetje dhe kërkesë. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës.

Monitorimi i mbledhjeve

Aktivitetit i Kuvendit monitorohet nga strukturat ndërkombëtare - OSBE-ja e cila i përcjellë mbledhjet e KK dhe KPF nga Faruk Dermaku, një kohë ishte edhe Gazmend Murseli, ndërkaq një mbledhje të KPF e ka monitoruar Rrezart Mehmeti. Nga strukturat vendore, monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës nga zyrtari, Gëzim Sahiti, një kohë janë përcjellë nga zyrtarja e MAPL, Vlorë Ahmetaj. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ të tjera, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit ka qenë minimal. Në fund të vitit 2022 është filluar me transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të KK -formë kjo shumë e mirë për të gjithë qytetarët, OJQ dhe grupet tjera të interesit me i përcjellë punimet e kuvendit.

Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Shërbimi i Kuvendit, Zyrës së Informimit përkatësisht Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të KPF-së, të Komitetit për Komunitete si dhe procesverbalin e dëgjimit publik të organizuara nga Kryesuesi i Kuvendit përmes KPF-së lidhur me buxhetin e Komunës. Vlen të përmendet së, i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2022 është i publikuar në faqen zyrtare të komunës. Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktiviteteve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: <https://kk.rks-gov.net/kacanik/>, Duke klikuar linkun: Kuvendi, hapen Linqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivite tjera të Kuvendit të Komunës sipas viteve.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës raportuese të gjitha aktet e miratuara për të cilat kërkohet shqyrtim i ligjshmërisë, janë dërguar Zyrës Ligjore të MAPL. Nga të gjitha aktet e dërguara në MAPL, me kërkesën e organit shqyrtues janë harmonizuar 2 vendime me datën 27.06.2022: 1. Vendim 01Nr.06-941/01-7953/2022 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private Z.K. Bob, PK nr.175-0; 2. Vendim 01Nr.06-941/01-7951/22 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105, ndërkaq po me këtë datë janë anuluar: Vendim 01Nr.06-350/02-7606/22 për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë bujqësore arë e klasës 5, me sip 3917m², pronë e Ekrem Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet; Vendimi 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore arë e klasës 6, me sip. 600 m²,pronë e KBI; Vendimi 01Nr.06-350/01-2433/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.300m² në parcelën kadastrale00311-0, zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës 6, pronë e Samedin(Vehbi)Rexha, ndërkaq me 02.09.2022 janë anuluar Vendimi për Anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e

të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë, sipas kërkesës së MBPZHR; Vendimi për Anulimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet, sipas kërkesës së MBPZHR, ndërkaq Vendimi 01Nr. 060/01 -20506/22 me të cilin kërkohet nga MBPZHR Rishqyrtimi i vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr. 06-350/02-16605/22 të datës 27.06.2022- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Blerim Çaka, nuk e ka marrë miratimin.

Aktivitete tjera

Me qëllim të shqyrtimit të problematikave, evidentimin e pengesave që hasen gjatë punës së Kuvendit dhe gjetjen e formave për tejkalimin dhe lehtësimin punës së Kuvendit në zhvillimin e politikave lokale, krahas punës së Kuvendit, ka pasur edhe aktivitete të tjera edhe jashtë Kuvendit, si të Kryesuesit të Kuvendit dhe anëtarëve tjerë të KK, organizuar nga MAPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendit, OSBE, DEMOS dhe OJQ të tjera. Nga aktivitetet tjera të KK, vlen të përmendet një vizitë studimore e anëtarëve të kuvendit, e realizuar në Republikën e Shqipërisë.

Spektori i Kuvendit

Punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të kuvendit, përgatiten nga një (1) zyrtar i punësuar në Sektorin për punë profesionale të Kuvendit dhe nga një(1) zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtarëve, përgatiten; mbledhjet, përpilohen Procesverbalet e mbledhjeve, Vendimet dhe shkresat tjera dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e komunës dhe të qytetarëve të saj. Të gjitha aktet e aprovuara nga KK, përmes këtyre zyrtarëve, pas nënshkrimit nga Kryesuesi i KK, në formë origjinale i dërgohen: Kryetarit të Komunës dhe drejtorive përkatës për ekzekutimin të tyre, ndërkaq Zyrës Ligjore të MAPL, i dërgohen në formë elektronike përmes zyrtarës së KK, për shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera nënligjore.

Përfundim

Nga të shënuarat si më lartë, nxjerrim një përfundim lidhur me aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2022, si vijon:

- Ftesa për mbledhjet e Kuvendit dhe materialet e mbledhjes janë dërguar, duke respektuar afatet e përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta apo maksimumin e mbledhjeve me pagesë, që janë të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale ;
- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për qytetarët, OJQ-t dhe grupet tjera të interesit;
- Monitorimi i mbledhjeve, nga strukturat ndërkombëtare është bërë nga OSBE-ja, ndërkaq nga niveli qendror nga MAPL, mbledhjet janë monitoruar përmes teleprezencës;
- Është mbajtur 1 takim publik me qytetarët nga Kryesuesi i Kuvendit në konsultim me KPF, për Buxhetin e komunës 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025;
- Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është bërë transparent në ueb faqen zyrtare të Komunës;
- Kryetari i Komunës ka raportuar 4 herë me raport të shkruar financiar, 1 herë pas konstituimit të KK para Kuvendit të Komunës; 1 herë me Raport të shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 dhe 1 herë me raport në emër të KKSBB për çështje të sigurisë;
- Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, ndërkaq Rregulloret janë publikuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës, ashtu siç i parasheh UA janë dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë, në afatin e përcaktuar ligjor, të përkthyer në dy gjuhë;
- Pjesëmarrja e Kryetarit të Komunës në mbledhje të Kuvendit ka qenë e përhershme në mbledhje të KK, ndërkaq kryesisht kanë marrë pjesë nënkryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive ;
- Incizimi i mbledhjeve është bërë përmes teleprezencës nga zyrtari i IT dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës, ndërkaq është filluar edhe me transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli



SHTOJCA:

LISTA E AKTEVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS NË VITIN 2021

I. VENDIMET

1. Inaugurimi (Konstituimi) i Kuvendit të Komunës Kaçanik të legjislaturës së shtatë (i dalë nga zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës, 17 tetor 2021)/ Lënda: 01Nr. 60/01-3634;
2. Inaugurimi (Konstituimi) i Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi (i zgjedhur në zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, në rundin e dytë të votimit të datës 14 nëntor 2021);
3. Vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit/ Lënda: 01Nr. 60/01-37407/21;
4. Vendimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 60/01-37388/21.
5. Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa / Lënda: 01Nr. 60/01-38152/21;
6. Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete/ Lënda: 01Nr. 60/01-38151/21;
7. Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 60/01-38141/21;
8. Vendimi për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022/ Lënda: 01Nr.104/02-38073.

LISTA E AKTEVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS NË VITIN 2022

I. RREGULLORET

1. Rregullore Nr.01/2022 për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës/ lënda 01Nr.07-217/01-7690/22;
2. Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr.346-18740/2013 të datës 29.07.2013 për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve / lënda 01Nr.346/01-7660/22;
3. Rregullore Nr.03/2022 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive në Komunën e Kaçanikut/ lënda01Nr.09-104/02-13257/22- Aprovuar me datë 31.05.2022- ende nuk kemi konfirmim të ligjshmërisë;
4. Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale / Lënda: 01Nr.07-60/01-25563/22.

II. VENDIMET

Kuvendi i Komunës Kaçanik në vitin 2022 ka aprovuar 74 Vendime, si vijon:

1. Vendim për formimin e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)/ Lënda 01Nr.104/02-1854/22;
2. Vendim për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës/Lënda 01Nr.08-322/01-1562/22;
3. Vendim për delegimin e dy anëtarëve të Kuvendit të komunës në kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës/Lënda 01Nr.104/02-1700/22;

4. Vendim për aprovimin e dorëheqjes së Artan Mezraja, nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara/Lënda 01Nr.60/01-2532/22;
5. Vendim për aprovimin e dorëheqjes së Argjenta Axhami, nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara/ Lënda 01Nr.60/01-2535/22;
6. Vendim për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Pastërtia" SH.A. -Njësia Kaçanik/Lënda 01Nr.104/02-4209/22;
7. Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve N.P.K. "stacioni i Autobusëve" SH.A. -Njësia Kaçanik;
8. Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 Z.K. Duraj, për këmbim me pronën komunale P.K. 00453-0 Z.K. Duraj/Lënda 01Nr.06-350/02-4567/22;
9. Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr.00139-2 Z.K. Biçec, për këmbim me pronën komunale PK-00162-0 Z.K. Biçec/Lënda 01Nr.06-350/02-4569/22;
10. Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik P.K.Nr.01306-2 dhe 01306-8 Z.K. Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore/Lënda 01Nr.06-350/02-4729/22;
11. Vendim për aprovimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
12. Vendim për dhënie në menaxhim të përkohshëm, parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike komunale KRM "Pastërtia" SH.A.-njësia Kaçanik/Lënda 01Nr.104/02-7676/22;
13. Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës të vitit 2022/Lënda 01Nr.400/01-7824/22;
14. Vendim për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit komunal për Siguri në bashkësi për vitin 2022/ Lënda 01Nr.60/01-7922/22;
15. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private Z.K. Ivajë, PK nr.585-2/Lënda 01Nr 06-941/01-4538/22;
16. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK. Kovaçec, PK nr.174-0/Lënda 01Nr.06/941/01-8081/22;
17. Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr.1579-2,1579-3 dhe 3126-0 zona kadastrale Begracë, sipas manualit të ofruar nga kompania gjeodete e licencuar/ Lënda 01nr.06-941/01-7338-22;
18. Vendim për aprovimin e Planit vjetor të punës së KKPAK për vitin 2022/Lënda 01Nr.60/01-8268/22.
19. Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022/ Lënda 01Nr.400/01-10746/22;
20. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private Z.K. Bob, P.K. nr.175-0/ Lënda 01Nr.06-941/01-7953/2022
21. Vendim paraprak për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Shtrazë, me kulturë tokë pyjore- Mal i klasës 4, me sip 637m², pronë e Kadri Lalinovcit./ Lënda 01Nr.06-350/01-3225/22;
22. Vendim për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Sopicë , me kulturë bujqësore arë e klasës 5, me sip.3917m², pronë e Ekrem Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet/ Lënda 01Nr.06-350/02-7606/22
23. Vendim për shtyrje e shqyrtimit të propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë bujqësore livadh i klasës 6 me sip.300 m²,pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku/ Lënda 01Nr.350/02-6286/22;

24. Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore/ Lënda 01Nr.104/02-10290/22;
25. Vendim për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër , me kulturë bujqësore arë e klasës 6, me sip. 600 m²,pronë e KBI/ Lënda 01Nr.06-350/01-2433/22
26. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në sip.600 m²,PK Nr.0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore arë e klasës 6, pronë e KBI/ Lënda 01Nr.06-350/02-10174/22;
27. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private Zk Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105/Lënda 01Nr.06-941/01-7951/22;
28. Vendim për shfuqizimin e vendimit 01Nr.327/09- për bartjen (delegimin) e kompetencës, Komitetit për Politikë dhe Financa/Lënda 01Nr.104/02-11076/22;
29. Vendim për Aprovimin e Programit komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025/ Lënda 01Nr.104/02-13207/22;
30. Vendim për Aprovimin e planit komunal për integritet 2022-2026/ Lënda 01Nr.104/02-13273/22;
31. Vendim për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale- SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" , në institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional-IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"/ Lënda 01Nr.04-416/02-12903/22;
32. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00255-3 ,zona kadastrale Vatë-Dubravë , me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevshet (Amet) Mema nga f.Dubravë/Lënda 01Nr.06-350/01-2433/22;
33. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.300m² në parcelën kadastrale00311-0, zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës 6, pronë e Samedin(Vehbi) Rexha / Lënda 01Nr.06-350/01-2433/22;
34. Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore(KAB) e komunës për vitet 2023-2025/ Lënda 01Nr.400/01-16882/22;
35. Vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokal/ Lënda 01Nr.104/02-16421/22;
36. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në PK 01208-2, mal i klasës 3 në sip. 504m² dhe livadh i klasës 3 sip. 1722m², në emër të Nexhmedin (Mustafa)Elezi/Lënda 01Nr.06-350/02-12630/22;
37. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.300m² në PK 000129-8 ZK Bob, në vendin e quajtur oborr, arë e klasës 6, pronë e Blerim(Ajet) Çaka/ Lënda 01Nr.06-350/02-16605/22;
38. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.350m² në PK 02302-2 ZK Kaçanik i Vjetër, arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Shoko Bare Kalishtë" pronë e Blerim(Qamil) Ilazi, nën qiramarrjen 99 vjet/Lënda 01Nr.06-350/02-13415/22;
39. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.300m² në PK 001334-13 ZK Kaçanik i Vjetër, arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina" pronë e Blerim(Qamil) Ilazi/ Lënda 01Nr.06-350/02-16695/22;
40. Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sip.300m² në PK 001334-12 ZK Kaçanik i Vjetër, arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina" pronë e Burim (Qamil) Ilazi/ Lënda 01Nr.06-350/02-16696/22;

41. Vendim për aprovimin e Planit të Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut/ Lënda 01Nr.104/02-16957/22;
42. Vendim për treansfer dhe rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022/ Lënda 01Nr.400/01-16994/22;
43. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private Z.K. Bob, P.K. nr.175-0, në emër të Bekim(Emrush)Dema-harmonizim i vendimit/ Lënda 01Nr.60/01-15020/22;
44. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105 dhe Drilon Shamolli- harmonizim i vendimit/Lënda 01Nr.60/01-15021/22;
45. Vendim për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, kulturë arë e klasës 5, sip.3917m2, pronë e Ekrem Hysenit nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet/ lënda 01Nr.350/02-16991/22;
46. Vendim për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, kulturë arë e klasës 6, sip.600m2, pronë e KBI / lënda 01Nr.350/02-16992/22;
47. Vendim për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, kulturë livadh i klasës 6, sip.600m2, pronë e Samedin (Vehbi)Rexha / lënda 01Nr.60/01-17413/22.
48. Vendim për transferin e mjeteve/ Lënda: 01Nr.104/02-20260/22;
49. Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë/ Lënda: 01Nr. 104/02-20245/22;
50. Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-19959/22;
51. Vendimi 01Nr. 060/01 -20506/22 me të cilin kërkohet nga MBPZHR Rishqyrtimi i vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr. 06-350/02-16605/22 të datës 27.06.2022- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Blerim Çaka/ Lënda: 01Nr. 060/01-20506/22;
52. Vendimi për Anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë, sipas kërkesës së MBPZHR / Lënda: 01Nr. 104.02-22552/22;
53. Vendimi për Anulimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet, sipas kërkesës së MBPZHR / Lënda: 01Nr. 104/02-22551/22;
54. Vendimi për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-19963/22;
55. Vendimi për mos aprovim të kërkesës së MBPZHR në kërkesën e Kuvendit të komunës, të datës 28.07.2022, lidhur me rishqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr.06-350/02-16605/22 të datës 27.06.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-25152/22;
56. Vendimi për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;
57. Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore/ Lënda: 01Nr. 60/01-25464/22;
58. Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve/ Lënda: 01Nr. 08-320/01-25452/22;
59. Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 09-60/01-25460/22;

60. Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 / Lënda: 01Nr. 430/03-27545/22;
61. Vendimi për Aprovimin e Planit të Veprimit për parandalimin e dhunës në familje/ Lënda: 2023-202501Nr.104/02-26050/22;
62. Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë / Lënda: 01Nr. 60/01-27947/22;
63. Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022/ Lënda: 01Nr. 400/03-28129/22;
64. Vendimi për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore / Lënda: 01Nr. 104/02-28334/22;
65. Vendimi për aprovimin e Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2026 / Lënda: 01Nr. 104/02-30293/22;
66. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026/ Lënda: 01Nr.104/02-30297/22;
67. Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore / Lënda: 01Nr. 60/01-30764/22;
68. Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-30793/22
69. Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj / Lënda: 01Nr. 06-941/01-30876/22;
70. Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë/ Lënda: 01Nr. 104/02-32169/22;
71. Vendimi për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023 / Lënda: 01Nr.104/02-32812/22;
72. Vendimi për Aprovimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-32951/22;
73. Vendimi për Aprovimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027/ Lënda: 01Nr. 07-104/02-33334/22.
74. Vendim për ndryshim plotësimin e komisionit të ankesave për procedurat e dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr. 60/01-33331/22.

III. RAPORTIMET E KRYETARIT TË KOMUNËS

Për çështje financiare, ka raportuar në legjislaturën e 7 të KK, 4 herë me raport të shkruar në vitin 2022 dhe 1 herë në vitin 2021:

1. Raporti Vjetor Financiar për periudhën janar-shtator 2021/ Lënda: 01Nr. 05-400/01-38144/21;
 - 1.Raporti Vjetor Financiar për periudhën janar-dhjetor 2021/ Lënda 01Nr.05-400/01-4717/22- me datë 28.02.2022;
 - 2.Raporti tremujor financiar për periudhën Janar- Mars 2022/ Lënda 01Nr.05-400/01-10486/22- me datë 29.04.2022;
 - 3.Raporti financiar për periudhën Janar-Qershor 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-2024/22. me datën 28.07.2022 ;
 - 4.Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022/ Lënda: 01Nr. 400/02-28046/22.
- Për çështjen e Arsimit, 3 herë, me raport të shkruar:
1. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022/ Lënda 01Nr.04-610/01-1727/22- me datë 28.01.2022;
 - 2 .Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-27776/22;
 3. Informatë për fillimin e vitit të Ri shkollor 2022/2023/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-27776/22.

Për aktivitetin e përgjithshëm të komunës, 1 herë me raport të shkruar:

1. Raporti Vjetor i Punës së Ekzekutivit të komunës për periudhën janar-dhjetor 2021/Lënda 01Nr.60/01-4535/22- me datë 28.02.2022.

Për çështjen e burimeve njerëzore, 1 herë me raport të shkruar:

1. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën janar-dhjetor 2021/Lënda 01Nr.104/02-4308/22- me datë 28.02.2022.

Për çështje të auditimit

1.Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021/ Lënda 01Nr.470/03-4558/22- me datë 28.02.2022;

2.Raporti periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra kombëtare e Auditimit, për afatin 15 mars 2022/ Lënda 01Nr.470/03-7566/22- me datë 29.03.2022;

3.Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021- me datë 27.06.2022.

Për çështje të Covid-19, 1 herë

1. Raporti i Shtabit komunal për parandalimin e Covid019, në komunën e Kaçanikut/ Lënda 01Nr.104/02-7822/22- me datë 29.03.2022.

Për çështje të Sigurisë:

1. Raporti i KKSBB për periudhën Janar-Qershor 2022. Lënda: 01Nr. 104/02-19514/22, me 28.07.2022.